


Nexhat Hakiq

# ZERI I FYELLIT



NEXHAT HAKIU

24352

PARLAMENTA E SHTETIT

F. JEDOV

12556

# Zëri i fyellit

(Ujersha)

N. SH. BOTIMEVE «NAIM FRASHËRI»  
TIRANE, 1959

## B A R E S H È S

Kur shoh vjollca dhe nergjize, çkulur, futur në  
një gotë,  
më zë malli, mbyll dhe sytë, më shkon mëndja  
lark e lark  
gjer te ty, baresha ime, se më ndrit një tjetër botë  
n'ato gardhe, që u çkulën, në kopët qënosur vark!

Ty të pash' me krrab' e furkë, kur gëzoje një sheleg  
nëpër gjurmat e kaprolles, që ish trëmbur nga  
gjahtari,  
kur nga linja e bylyrtë nxorre dorën dhe me degë  
ndreqe vathën, ku mbi ujkun kishte marr' nishan  
shterpari.

Këto vënde të xhurasë, të barotit, të burimit  
ty të mbrujtën gjerakinë, po dhe flutur, se më rri  
përmbi bar e lart në dega, luan me rrezet e agimit,  
njom dhe syt' me bulave, tjerr e çlodhesh në  
sohi.

Ta dëgjova edhe zërin kur me shqerrat mërmërite,  
kur një këngë partizane ti këndove me sa gas,  
pa m'u skuqe dhe më ike, më le vetëm, më mah-  
nite:  
Zër' i fyellit po dëgjohet nëpër gjurmat që le pas!..

## GAZE PAÇ TI PASKĒTAJ

### I

Vaj-medèt, çobankë, vaj!  
Qaj, çobank' e vogël, qaj  
se kasollja ty t'u doq  
se manarja ty t'u poq!  
Qaj, çobankë, që të qaj:  
jeta qënka gaz e vaj!...

Moj e gjor' çobank' e gjorë,  
mbete, moj, me krab' në dorë:  
T'iku dashi me këmborë,  
vaj-medét, çobankë vaj!  
Qaj, çobank' e vogël, qaj:  
jeta qënka gaz e vaj!...

Bu-bu-bu çobankë, bu,  
bo-bo stani seç t'u doq,  
pu-pu nëna seç t'u poq!  
Ku je ti, çobankë, ku  
mbete qyqe dhe kërcù!

### II

Qesh, çobank' e vogël, qesh  
trimat ty të prunë desh  
dhe të ngritën një shtëpi  
mbi gërmadh' e shkrumb e hi,  
që na la armiku- i zi!

Qesh, çobank' e vogël, qesh,  
pa hidh sytë dhe mbaj vesh:  
Atje rrëzë të një shkëmbi,  
ku armiku dogji, shëmbi,  
s'ka kasolle, as koçekë,  
po shtëpi edhe hambare,  
ndihen këngët me zambare,  
uturima e traktorit,  
sokëllima e fiçorit!

Qesh, çobankë, qesh mos qaj...  
Ashtu, deh, se s'ka më vaj,  
gaze paç ti paskëtaj! ...

## BANUSHJA

Nëno-shpirti, nëno-xhani,  
m'u ngushtua xhamadani  
edhe linja m'u shkurtua,  
nëno-gazi, sa të dua!

Kur me shtëmbën shkoj në krua,  
llërët, pulpat marrin sheshin,  
më vjen turp, nënoçe, mua:  
gjithë shoqet po më qeshin!

M'u fry gjiri, shpejt u zgjata,  
po më ndjek një trim nga prapa,  
po më nget, e zuri malli  
për gërshetat vijë-mali!

Nëno, moj, më skuqen faqet  
kur fërshllen e dredh mustaqet,  
nuk e di se ç'ka me mua  
trim'i fshatit si dragua!

Moj t'u bëfsha, eh ç'të them,  
ah, më mirë mos të jem,  
m'erdhì pranë mu në krua,  
pa zu' foli dhe me mua...

Moj të keqen, e ç'të them,  
s'e them dot, moj, turp të kem,  
thirri trimi: — O mes-ngjalë,  
dale, moj, të kam një fjalë! —

Në shtëpi kur unë vija  
prap' — Banushe! — thirri trimi,  
tek vrapova, ra shamia,  
më ra shtëmba nga nxitimi! . . .

Nëno-shpirti, nëno-xhani,  
m'u ngushtua xhamadani,  
edhe linja m'u shkurtua,  
nëno, trimin. . . un'e dua! . .

## TË KAM ZILI...

E hodhe lahurinë dhe nusërin' harrove,  
i mblodhe dy gërshetat, i thure si kurorë,  
kujtimin e një jave me tjetër gaz e shtove,  
se për në Moskë Zela kish ikur me vapor...

Të kam zili, Banushe, ti je për jetën dritë,  
atë që ke larg syvet, ormisi zemr'e dlirtë,  
dhe ty, o shok, të dashka: me kazmën nëpër ara  
e shkoi nusërinë, me shoqet nëpër gara...

Sa mirë ti rrëmive një tog me dhë të ngjeshur,  
sa hije ty të kishte mbi brazën, ndër ugare,  
kur tok me shoqet mbillje, me krahët e përveshur,  
me llërë fshije djersën dhe rrije si manare!

E kam zili teftikun e farës që ti mbolle,  
ajo do çajë dheun, mbi plisat do vërvitet,  
dhe prap' me dorën tënde, se drit'e ves' i solle,  
si fije ar kalliri më tepër do të rritet...

Aher' nga Moska mike dhe Zela do të vijë  
kombajnën më të parë do sjellë për dhuratë,  
kur tok me ty, i pari, do korrë e do shijë,  
ahere më e nurçme do dukesh ti në fshat!

## SIKUR TI TË DIJE

Moj baresh' e fshatit, sikur ti të dije,  
se murtaj' e zezë në bagti më ra  
ti posi një motër, vallë do më lije  
të kaloja pakëz në këtë merá?

O, sa shum' i dua, sikur ti të dije,  
dhëntë kur mérzejnë, zoqtë në folë,  
ti posi një shoqe, shoqe dhëmbshurie  
do më lije pakëz brënda në kopé?

Që jam lodhur shumë, sikur ti të dije,  
e që humba rrugën, ndaj po vi vërdallë,  
ti posi mikeshë, vallë do më bije  
pakëz buk' e kripë, një çetûr me dhallë?

Meqë nuk kam fjetur, sikur ti të dije,  
të shtegtoj nuk mundem nëpër monopate,  
si një trim të fshatit, vallë do më lije,  
qoftë dhe në pragun e kasolles sate? . . .

## II

Në pragun e kasolles çobani vuri kokën,  
përsipër ndritnin yjet, ndën shtatin kishte tokën  
përreth dremitnin dhëntë, e ruanin mos të fto-  
hesh,  
mezi e zuri gjumi, në ëndër po gëzohesh:

«Çoban, çoban, çoban!» një zë nga fund' i dheut sikur i pëshpëriti, pa vetëtiu dhoma, çobanka më e bukur nga bukurë e dheut çobanit pran' i vajti, një çik më larg nga stroma!...

Çobani, yll i bukur, gëzohej nëpër gjumë, iu duk sikur s'qe ëndër, vërtet' çobanka ishte e shtritur pranë stromës si vala plot me shkumë kur shtrihet dhe tërhiqet lë gjurmat mbi ranishte!

«Çoban, çoban, çoban!» një zë nga fund' i dheut i mërmëriti prapë me ngashërim e mall, çobanka më e bukur nga bukuri e dheut çobanin këtë herë, e puthi mu në ballë!...

Edhe një herë tjetër thërriti: «O çoban!» porse çoban' i gjorë si thellë psherëtinte, se kur te stroma prapë i vajti fare pranë, u zgjua dëshpëruar: një qëngj po e lëpinte...»

U ngre çoban' i gjorë, nga zemra hoq' pa zë, u nis me krrab' në dorë, çobankën s'ë pa më!...

## PSE U FSHEHE ? . .

Pse u fshehe, moj perrl,  
kur tē pa stopan' i ri?

Ai ty t'i hodhi sytē,  
tē këndonte ç'ishin shkruar,  
se pa veten vet' i dytē  
nē një pyll tē gjelbëruar,  
ku po bridhte nëpër èndër:  
ti si nuse, ai: dhëndër!

Pse guguçe u turpërove  
dhe stopanin s'e dëgjove?

Ai ty, moj, diç tē tha,  
tē tregoi ç'ëndërriti,  
zér' i nënës që s'të la  
më përpara sokëlliti  
edhe ike, kanakare,  
trimin s'e përfille fare!

Pse u trëmbe, vajzë-prilli,  
kur tē ndali ty bandilli?

Ay ty ta ndëri dorën,  
e kish plot me jasemina  
që këputi për kurorën  
tok me shqerrat nē lëndina,  
Po ti shkove, moj sorkadhe,  
mbeti trimi nē livadhe! . .

## SA HERE FUSHA GJELBERON...

Sa herë fusha gjelbëron,  
ti çel si lulja në pranverë,  
sa herë mali zbardhëllon,  
ti lule prapë kurdoherë!

Si mot dhe sot, si lul' e mitur  
ke hedhur rrënj' te zemr' e ngratë,  
po ja me vjete të kam pritur,  
lum vesa lum që të spërkatë,

Ti nuk më flet, un' s'të flas dot  
e zemra jonë psherëtin:  
kur njerën dorë mban mbi shportë  
dhe mbi kajsinë tjetrën shtrin!

E kur dëbora zbardh mbi mal  
dhe rri si lulja në saksi,  
aher' nga malli që më fal  
këndoja si zogu në kuvlë.

Do pres pranverën dhe një herë  
edhe me ty do mërmëris,  
do të këpus një lule-shqerrë,  
kur tok me ty do të prashis...

## XHA TEMJA

Blegërin në mal të thatë  
delja rudë, që menatë  
po këndon edhe këndezi,  
kokorisin te qymezi  
pulat, klloçkat në mëhallë,  
po xha Temja ka një hall:  
Me përtim ai po ngrihet,  
as në shtrat nuk po i rrihet,  
kap hostenin, shkon te qetë,  
nga marazi po pëllcet! . . .

Zbardhëllói, po xha Temja  
rri e rri duke menduar,  
ndihen hapat edhe qerret,  
krisi kënga e mëngjezit,  
hingëllimat, hamulitjet  
dhe kikiku i këndezit,  
një e qeshur dhe bërtimat...  
thonë: puna ka filluar!

«Ç'ka xha Temja, a e dini?  
O xha Teme, do ta them.  
ju xanxarë mos e ngitni,  
se pastaj na bën ujem!»

I këputet shpirti Temes  
për hostenin e për qetë,

se që sot e tutje n'arë  
do të shkelë një lanet:  
Eshtë bisha e xhindosur,  
që bërtet e shkel nga dora  
e si thotë vetë Temja  
e ka emrin trakatora!

E si, vallë do punohet  
nga t'ia nisë Temja, hë?  
Qetë Zoti i bekoi,  
ato sjellin mbarësi,  
nga bërtima trëmben ëngjëjt  
edhe fara s'ka si zë:  
Babëzi do të na sjellë  
trakatori ugurzi! . . .

Shkulet gazit fshat' i tërë,  
po xha Temja mvrejtur rri.  
dilnin plisat sërë-sërë,  
po vështronte me habi  
edhe thoshte: «dale-dale,  
dardha bishtin e ka prapa  
si në fusha dhe në male,  
kur t'ia ndezë piskë vapa,  
do të thahet, do vështroni,  
fara juaj me lanetin,  
pa do zini të më thoni:  
«S'bëhet luftë me kësметin!»

Me të sosur fjalët Temja  
ia dha bisha ulurimës  
e me bisht e krah e feçka  
çante dheun, dilte plisi,  
Teme-ziu uli kryet,

iu largua ushëtimës,  
porse veshët cërr i bënин  
kur po rrinte pran' një lisi!

## II

Blegërin në mal të thatë  
delja rudë, që menatë  
po këndon edhe këndezi,  
kokorisin te qymezi  
pulat, klloçkat në mëhallë,  
po xha Temja ka një hall:  
Me përtim ai po ngrihet,  
as i haet as i piet,  
me njeri nuk po i rrighet,  
këmbët hiqte osh e zvarë  
e me bisht të syrit n'arë  
po përgjon e po mendon...

Po sheh grurin se korriku  
ia hodh shtatin si llastar,  
ndritnin hálat edhe kokrat,  
vetëtinin si flori,  
zjente puna edhe kënga:  
Normën kush e sos më parë.  
vetëm filli, i menduar,  
në një hije Temja rri!

Nip'i Temes, traktoristi,  
hedh ca fjalëza me thumba  
tok me Rinën, me Banushen,  
sheh xhaxhan që rri habitur,  
po për Temen fjalët, gazet  
qenë thika, qenë plumbë,

kur kanalin po vështronte  
që gjith' arat kish vaditur!

Lëmi për karshi,  
gruri si flori,  
kënga që gjëmonte,  
puna që valonte  
(sepse lëm'i parë  
shtetit si pérherë,  
gaz i till s'ish parë  
kurrë ndonjë herë)  
vërshëllimat pranë,  
fyelli për matanë,  
më tutje zambaret  
këtej kanakaret,  
trimat që këndonin,  
zoqt' që cicëronin:  
Temen e shastisën,  
mëndjen ia vidhisën!...

Ashtu si një plak  
priti gjer në darkë,  
priti sa të iknin,  
të thërriste nipin:  
Traktorist Petritin!

— O Petrit, shejtan i xhaxhit,  
p'eja se të kam një fjalë,  
mos i thuaj asnjeriu,  
nga ty fjala mos të dalë:  
Ma mëson traka... traktorin  
se un' vetë do punoj,  
pa do shihni që të gjithë  
se sa shpejt do t'ju kaloj!

27352  
BIBLIOTEKA E SHTETIT  
COMUNISTI

## JA, ÇOBANKA...

12556

Ja çobanka si po bredh  
shkëmb mbi shkëmb e ledh mbi ledh,  
ia vërvit fustanin era,  
nëpër driza, nëpër ferra!

— Moj, çobankëz'e çobanit,  
ç'ke që bredh matanë stanit?  
Kaç e butë posa shqerrë,  
pse nuk qesh, moj, si pérherë? —

Bredh çobanka, sokëllin,  
se la vetëm bagëtinë  
dhe 'në gërxhet shpejt u fut,  
mos ish fshehur delja-krutë!

Rri çobanka majë-shkëmbi  
dhe vështron përposh në prrua,  
qan e qan se shum' i dhëmbi  
delja-krutë q'u thërrmua!

Qan çobanka se çobani  
do ta pres' me shkop te stani,  
qaj, çobankë vogël, qaj,  
ti nuk pate ndonjë faj!

Po më fort nga delja-krutë  
loti yt po më këput,  
qesh, çobankë, qesh, mos qaj.  
gaze paç ti paskëtaj!

## E MBAN MËND...

E mban mend, moj, në korie,  
kur qershinë vet' e mbolle,  
kur me thuprat, që më bije,  
të ndërtova një kasolle:  
me derickë, me avlli,  
ku do hynte dhëndr'i ri  
edhe nusja çilimi,  
me dy krushq si un' e ti?...

Nusen, dhëndrin i stolise,  
O, sa hije ty të kishte,  
kur u veshe dhe u nise!  
Un' akoma me barishte  
po mbuloja dhe çatinë...  
Kur ja, shiu, suferina,  
me rrufe, me bubullima,  
prishi nusen në kasolle  
dhe qershinë që ti mbolle!...

E mban mend, moj, edhe sot  
kur si çurg 'ti derdhe lot,  
se furtuna edhe shiu  
nuse-dhëndër i përpiu...  
Brodhëm bashkë nëpër ara,  
në çaire, nëpër lëmë,  
kush të mbrinte më përpara,  
se të shante ty jot' ëmë  
dhe s' të linte prap' të vije  
atje sipër në korie,  
ku qershinë vet'e mbolle,  
ku të ngrita një kasolle!

## MIRSEVJEN O KURBETLI!...

- Pun'e mbarë, o moj grua!
- Mbarë-paç, or udhëtar!
- A ka pranë ndonjë krua,  
se kjo buzë m'është tharë?
- Ja përtej, n'ato zallishtet,  
gjëndet kroj'i fshatit tonë,  
ësht'i mirë se buron  
andej sipër nga lajthishtet!
- Po ti vetëm korrke grurin,  
ku ma ke, kärcüre, burrin?
- Nuk jam vetëm, shih matanë  
shoqet korrin tutje n'arë,  
shih dhe burrat si asllanë  
mbarin dùajt gjith' në garë!
- E po burrin ku e ke,  
mos ke mbetur nus'e vé?
- Më ka shkuar në kurbet,  
gjithëmon më ka kujtuar,  
veç tani ka disa vjet  
as një kartë s'më ka çuar!
- Mjera ti, e pret më kot,  
me të tjera qesh e lot!...

— Ej, mbyll gojën, o shejtan,  
ik këtej, mos rri kaq pranë!

— S'të gënjej, më plaçin sytë,  
ai ndodhet vet' i dytë,  
kurse ti pa 'të po korr,  
më të lumtë ajo dorë:  
gruri hedhur si llastar,  
kokrrat ndrijnë posì ar!

— Thuaj mashalla, qyqar,  
se pastaj ma merr më-sysh,  
syr' i botës ziliqar  
edhe gurin ndan më-dysh,  
po ti prapsu, ik në krua,  
mos më bjer' më-qafë mua!

— E ç'më shpie n'ato vënde?  
Lem' të pi në shtëmbën tënde,  
mos ki frikë, s'ka njeri,  
brenda grurit fshehur rri  
dhe aty, në dorën tënde,  
në pëllëmbën kup-ergjënde,  
pika uji do rufis,  
në paç turp nga far' e fis,  
derdhmë uj' aty në arën  
a te gjurm' e këmbës sate  
a në grop' t'asaj lopate,  
ku ti vetë hodhe farën!

— Ej, ç'po flet, mos humb toruan,  
si kaq shpejt harrove kruan?...

— S'e kam humbur, o moj grua,  
po ti eja tok me mua,  
burri ty të ka harruar,  
me një tjetër ësht' martuar!...

— Mos më fol, o gojë-shtrig,  
o çapkën, o zemër-lig,  
burrin tim e zuri malli  
dhe në s'vjen të rrimë tok,  
do ta qaj-o për së gjalli  
me shami të zez' në kokë!

.....

— Ah, moj syskë, të kam zgjedhur,  
je besnike, s'më ke dredhur,  
nuk më njeh me të vërtetë,  
apo do e bën ti vetë?...  
Jam yt shoq, moj kurbetliu,  
nusërinë që ta nxiu!  
Pse po rri kaq e menduar,  
mos ti vall' më ke harruar?

— Si të njoh, ah, un'e mjera!?  
Me ty ndënja dy-tri netë  
dhe më dole shpejt nga dera,  
ikën vjete, mbeta shkretë,  
qëkur shkove në kurbet!...  
Un' akoma s'të besoj,  
në s'më thënç nishan'e trupit  
e në s'qofshë burri im,  
në s'u skuqësh dhe prej turpit,  
ty të rënt një vetëtimë!...

— Po, moj grua-gjerakinë,  
ke të fshehur n'atë gjinë  
një merxhane posa hëna  
një rublın kujtim nga nëna,  
një nishan të ndrit si yll

tutje gushës, në krahruar...  
Jemi njojur në një pyll,  
atje jemi dashuruar...  
Të kujtohet, shtat-billionjë,  
kur për mua ti ormise  
brenda gjirit nja dy ftonj  
dhe te nëna shpejt u nise? —

Lot'i mallit, lot'i gazit  
zbuti zemrën e marazit,  
nga gjëzimi u hutua  
e mbi grurin u lëshua:  
— Dhimitraqi qënke ti,  
Mirsevjen, o kurbetli,  
lumja un' për ty tan! —

Valavitet grur'i pjekur nga krahror'i kurbetluit,  
me nxitim i shtyn kallintë si me krahët e veriut,  
i përkul gjer te Vitorja, që e priti me sa mall,  
gjer te molla e shartuar, ku ka mbirë lul'e rrallë.

E si shkon me hap të rëndë dhe me duar kreh ka-  
llintë,  
nga fytyr'e gruas dehet, nga pëlhura e florintë.  
që kish endur rrez'e fundit, drit'e djellit në pe-  
rendimin,  
që tan te buz'e malit i dha hënës përqafimin.  
Po pshertinte zemr'e ndezur, buz'e tharë për një  
ballë,  
brenda grurit kokë-ulur q'e përkuli me sa mall  
dor'e regjur e Vitores, që e rriti si llastari,  
shtat'i saj posaçët selvia, hequr-tretur posaçët bari!

Ububu, se ç'u hepu kur pa lulja burr'e grua!  
Ububu, ç'u qetësua dhe rrëkeja tej në krua!  
Ububu, ç'u përmallua dhe bilbili kur vështroi!  
Ububu, ç'u turpërua edhe hëna kur ndriçoi!

— Vemi në shtëpì, o burrë,  
se do flesh, je lodhur shumë!

— Dale, grua, se mbi grurë  
unë son te do bëj gjumë! . .

## LUM TI LULE . .

Lumti, ti lule, që nuk qan,  
se me shoqet çele ti.  
as shtërgata s'të përlan,  
të shkrep rrezja mu në gji ! . .

Lum, ti rreze, lum dhe vesa,  
puthët lulen që të rritesht,  
lum, ti lule, s'të zu' lesa,  
po të la më lart të ngjitesh ! . .

Ra një breshër dhe të thau,  
po të vyshkur të këputa,  
u mvrejt qjelli edhe qau,  
kur në zemër ty të futa . .

Lulja prapë u përtëri,  
gjin' e fletëzat i shtriu,  
s'kishte frikë bor' e shi,  
se në zemër ajo mbiu !

## **U POQ RRUSHI...**

Moj, kopshtare, u poq rrushi  
dhe kajsia më një thyhet,  
posi faqet q'u ndrit pushi  
posi gjiri që po fryhet...

Eja, moj, t'i vjelim tok  
ranë kokrrat nëpër tokë,  
unë zgjedh e ti këput,  
ca në duar, ca në futë!

Në se degat nuk arrin,  
bëhem krrabë, bëhem shkallë,  
përmbi mua dorën shtrin,  
o moj vjelëse e rrallë!...

Eja, moj, pse nuk më flet,  
hajt t'i vjelim, më nuk rriten,  
tok me ty, se unë vetë  
t'i këpus kam frik' se vritten!

## F A L L I

Kur tē pash' së pari,  
mbeta shtang, qyqari,  
thash'e dhash' me vete  
po ti penk më mbete!

Kur tē pash' së dyti,  
thashë: «jam i yti»,  
po ti s'fole fare,  
o moj kanakare!

Tē pash' pér së treti,  
kur në drizë mbeti  
kinda e fustanit  
dhe kur xhamadanit  
fshiku deg' e blirit  
mbi gjerdhan tē gjirit! . .

«Lumthi dega, lum»  
psherëtita unë,  
po ti s'pate ngé,  
as një fjalë s'the!

Pyéta lule-shqerrën,  
brodha gjithë verën,  
po trifil nuk gjeta,  
s'kish me katër fleta!

«Aman, shok, aman,  
jam, i thash, në hall!»  
«Gjej, tha, një nishan  
edhe shko hidh fall!»

.....

— Bir, të keqen, bir,  
qënke kimetli,  
qënke xhevaïr,  
trim edhe sojli!  
Një sëmundje, bir,  
paske hequr ti  
dhe një mall i mirë  
në shtëpi do vijë...  
Po ç'më thotë falli:  
Të ka zën' meraku  
sa që s'fle nga halli!

Ja, ku del ftyra,  
ndrin posa pasqyra,  
qënka shum'e bukur,  
po ka frik'e gjora,  
se i dridhet dora,  
është njomë, lule,  
ti nga pas s'i shkule!  
E ç'të them, o bir,  
s'e ke punën mirë,  
nuk e ke kësмет,  
po ti mos u tret,  
Zoti ësht' i madh,  
bën dhe mehramët!...  
Më s'ke gjë, o bir,  
hakun bëm' hallall,  
jam fallxhesh'e mirë,  
me shëndet ky fall!...

.....  
Seç më ndezi falli,  
pa m'u shtua malli,  
prap' te shoku vajta,  
veten s'e përmbajta! . . .

«Merre, më tha shoku,  
këtë lëng të zi,  
bëra një magjì  
te një plakë-shtrigë,  
te një zemër-ligë!  
Më këtë spërkate,  
po t'u zëmërua,  
po të bëri naze,  
e rrëmbé për grua  
vashën me çapraze! . . .»  
.....

Tutje, lart në mal:  
kënga valë-valë,  
valle dhe dolli  
për një çift të ri!  
  
Në shtëpi të vashës  
hije paska rënë:  
vetëm bab' e nënë,  
mbushur syt' me lot  
presin më të kot! . . .  
Mali plot me dushq  
rreth e rrotull krushq  
lidhën një krushqì,  
jo me hajmali,  
yshtje dhe magji:  
Trimi e rrëmbeu  
vashën mu në gji,  
vashës ç'i pëlqeu  
pranë tij të rrijë!

## U RRËMBYE NJË VASHË . .

### I

Një natë  
pranvera zbriti me burbuqe,  
të kuqe-flakë, sa të kuqe ! . . .

Dy yje  
në pyje,  
më ngjan,  
se ranë . . .

Matanë  
u çel një portë !

Dy sy me lot  
xixëlluan  
n'errësirë, në fshehtësirë ! . . .

A ishin yjet  
që ran' në pyjet,  
a syt' e saj,  
s'i pa njeri !  
As më pastaj  
kur porta u mbyll  
përsëri !

As ky katundi,  
se më së fundi

zu' dremiti,  
veç hëna vetëm,  
kur sipër ndriti  
mbi vetull mali,  
pa gjurma kali  
edhe dy hije  
tutje në pyje! . . .

## II

Ule vetullën, o mal,  
sa të dalë hëna,  
eja trim e fol një fjalë,  
se po qan kjo nëna:

— Hënëzë, moj hënëzë,  
a pe vash-thëllëzënë?

— A e pe, o trim me fletë,  
vashëzën me një gërshetë!

— Nuk e pashë, po më thanë:  
Atje sipër në korë  
plot me dushqe, plot me thanë,  
atje rrëzë një qershie,  
nusëron kjo jotë-bijë  
me një trim mustaqe-zi,  
se kur qenë cilimi  
luànin tok në bor'e shi  
sybyllazi, me tèrkuzë,  
hop aty e hop këtuzë,  
mbanin fjalëzën në buzë  
sa q'u tretëni si qerì . . .

Po tani, o sa çudi:  
po ndërtojnë një shtëpi  
atje sipër n'ato pyje,  
kur ka hënë, kur ka yje... —

Ulet mali, hëna s'dolli!

— Ç'pate, hënë, që s'ndriçove?  
— Ndrita vashën që diç mbolli  
atje sipër në korie,  
ndrita dhëndrin që ndërtoi  
atje rrëzë një qershie,  
ku nuk mbinte bor' e shi,  
vetëm nuri derdhesh fije  
përmbi krah të çiftit ri ! —

## K A J S I A

Përse ankohet kjo kajsia  
që rri ashtu në dridhëtirë,  
vall' hoqi shumë nga stuhia,  
a pse ka rrënjet n'errësirë?...

U poq, andaj tani kajsia  
rri rënd e kokrrat fsheh ndër fletë,  
po ja me gurë çunëria  
të gjith' e shkundi, e la shkretë!

Po ja dhe kokrrat lart në majë  
që prapë fshehur mban kajsia  
i merr lopçari që t'i hajë  
tok me bareshën, te sohia!...

Në prag të vjeshtës prap' kajsia  
i hodhi fletët një nga një,  
po ja tani as çunëria,  
as trim e vashë s'duken më!

## DOLLI REJA ...

Dolli reja përmbi mal,  
zuri rrezet dhe ngadal  
zu' vesoi...

Pik'e shiut ra mbi fleta,  
pa u trëmb dhe flutur-shkreta,  
fluturoi...

Ja baresha dhëntë-tufë  
shpejt i fshehu në një gufë,  
vetëtiu...

Po bariu vetëm mbeti,  
te baresha streh nuk gjeti,  
psherëtiu...

Ikën vashat nga burimi,  
thyen shtëmbat nga nxitimi  
dhe rënkuani...

Ja matanë edhe nuset  
lanë kovat nëpër puset  
dhe vrapan...

Kanarina krahët shkundi,  
ndali këngën, më nuk mundi,  
se u lak...

Po folen ja kish marr' era,  
ndaj u fut në gjeth'e ferra,  
ra në lak...

Ja shterpari, ërr me vrap,  
te një portë ndali prapë  
dhe kolliti...

Po sy-zeza vetull-pë  
von'e hapi, nuk pa gjë,  
ndaj s'e priti !...

Ja, përtej në një bregore,  
ndriti vetullën brerore  
ylyberi...

Nisën foshnjet brohorimat,  
po dëgjohen fërshëllimat  
nga delmeri...

## ÇELU, MOJ, SI ÇELET MOTI . . .

### I

Ngrohen gjethet, shkrihet vesa,  
çelin gonxhet ndaj agimi  
si çel malli nga kujtimi,  
kur mbi brengën lindi shpresa.

Mallin, mike, ta këndova  
kur m'i hodhe fshehtas sytë,  
po me vete ligjërova,  
sikur t'ishja vet' i dytë.

Më vështro, moj sy-mëshqerre,  
se nga sytë t'iku loti,  
vashë-vashëzo-pranvere,  
çelu, moj, si çelet moti!

### II

Zu' gjinkalla t'i këndoje  
lule-kuqes nëpër fushë,  
dhe burimi të rënkoje  
nëpër buzë e nëpër gushë.

Dil, moj nure, mos rri brënda,  
shoqet shih si janë turur,  
ja po mbjellin ç'u ka ënda  
përmbi supe flokët çthurur!

Tok me shoqet vallen merre,  
syt' e tu s'i njom prap' loti  
vashëzo, ti vashë-verë,  
çelu, moj, si çelet moti!

### III

Në lëmishtet ndrin kalliri,  
që me shoqet tok e mbolle  
gushës ndrin një lule bliri,  
ndriti vëndi kur ti dolle.

Po ti, moj, ndriçon më shumë,  
bëhe ëndër dhe në gjumë  
më kujton: kur ne symbyllë  
luanim tok atje në pyllë!

Ndritmë ti, moj dredharake,  
se nga sytë t'iku loti,  
vashë, vashëzo-vjeshtake,  
çelu, moj, si çelet moti!

### IV

Frym murrëj e malet zbardhen  
nëpër gérxhet mardh sorkadhen,  
shuhet malli i gjahtarit  
për planozat e beharit.

Dridhet buza nga thëllimi,  
ndizet zemra nga kujtimi,  
edhe moti po na shkon,  
mua lëmza më kujton . . .

Më kujto, o moj rrezore,  
se nga sytë t'iku loti,  
vashëzo, moj dimërore,  
çelu ti, të çelë moti!

# M I N E J A

(Poemë)

## I

Në tē vagëlluar,  
sa këndon këndezi,  
qengjin në krahruar,  
furk' e bosht te mezi,  
po kalon Mineja,  
blegërin kopeja ! . . .

Bregut tatëpjetë  
Po na zbrejt Mineja,  
buzë-lumit pret  
sa tē pij' kopeja,  
lot dhe me shelegun,  
ngjitet prap' mbi bregun . . .

Tek po ngjitej brinjës,  
trapin kapërten,  
kindat rrotull linjës  
driza ja mbérthen:  
seç hutohet trimi,  
ç'gurgullon burimi!

Bredh nëpér lëndina,  
lot dhe me shelegun,  
jepen fërshëllima  
tejpërtej mbi bregun:  
del një trim mbi ledh,  
sytë shpejt ja hedh ! . . .

Mënia, çup' e mbarë,  
ul përherë sytë,

ikën trim' i parë,  
del një trim i dytë,  
ajo skuqet, dridhet  
pranë qengjit mblidhet.

Mbushur me marâs  
qengjin në krahruar,  
ecën e hutuar,  
lulja çel në ças.  
— Ç'u bë Cane trimi? —  
shushurit burimi . . .

Shkon e vjen Mineja,  
qengjin mban në gji,  
nuse dhe të reja  
mbushen me zili,  
edhe trimat thonë:  
— Canen po kërkon! —

\* \* \*

Ja dhe Cania tej bregores, tundesh-shkundesh për  
në stan,  
hedhur krrabën sipër supit dhe takien përmby sy  
nguli sytë si shqiponja, se Minenë pa matanë,  
buz' e zemër tok i qeshën, lum kush ndjente si ay!

Hedh takien edhe krrabën, nxjerr sojakun e fildi  
shtë  
e me këng' e fërshëllima zë e pret një degë thanë,  
nga nxitimi shket sojaku edhe pritet pak në gisht,  
po ky Cania, trim i fshatit, me një herë gjen  
derman!

— Qënke ulur buz'-burimi,  
ej, ç'po bën, o Cane trimi? —  
Cania s'flet prandaj ngre supet, ja ka marrë  
shtruar këngës,

këmbë-kryq mbi bar të njomë jep e merr me degë  
thane,  
e kur djersët i kullojnë, ballin fshin me cep  
të mëngës,  
heq nga zemra se Mineja nuk po qaset kësaj ane!

— Të këndoftë zemra, Cane,  
ç'po na bën me degë thane? —

Prapë Cania as ngre sytë, kokën tund dhe fërshë-  
llen,  
e njeh zërin e Minesë, as me një nuk shëmbëllen,  
veç burimi, që ka pranë, pak i ngjan kur del me  
naze,  
i përngjan edhe kajgushi, kur dredh këngën me  
tallaze...

— Bré... jo n'arë, këmbë-tharë! —

Ndjeu zërin e Minesë,  
që nxitoi tej kopesë  
gjer te shtegu për matanë  
të kap' cjapin laragan,  
ndaj i ngriti syt' e pa,  
po një fjalë nuk i tha !...

Ja Mineja tok me tufën ecën-ecën dhe sheh prapa,  
dhe gjinkalla majë-shelgut po këndon, se nisi vapa,  
tej mbi arat plot kallinjë vetëtinte drapëri,  
nëpër hidhëza e driza férshëllente gjarpëri...

Vjen Mineja, vjen perria, nûr lëshon e gjith'  
gëzojnë,  
ftohen shoqet, ndizen trimat, hapin sytë pleqt'  
në hije,

cicërojnë gjithë zoqtë, si në pritë po qëndrojnë,  
ja, po ndihet këng' e zemrës, Cania cules po i bije...

— Mirsevjen, o moj Minë,  
Cane trimin ku e le ? . . . —

E ngacmojnë shoqet pranë  
her' në lëm' e her' në stan.

Ç'thot' xhuraja, pa dëgjoni, është zemra që po rreh;  
zër' i Canes, që dëgjohet si jehonë valë-valë,  
del nga gishtat, gudulitet, për Minenë diç po fsheh,  
ndaj e skuqur kolopuçja, po dëgjonte disa fjalë . . .

— Pse u skuqe, moj Minë,  
për ty Cania bën dhe bë ! —

Prapë shoqet po i flasin,  
si përherë po e ngasin . . .

Ja, zambarja psherëtinte, ngriti trimat, vashat  
çmëndi  
dhe Minën kaq e mahniti sa la vetëm bagëtinë,  
edhe zoqtë s'po këndonin, ledh më ledh ushtonte  
vëndi,  
se ky Cania kur ja thotë, rëgëtin për dashurinë! . . .

— Lumja ti, o moj Minë,  
për ty Cania ësht' bilbil,  
lum ti Cane, lum dhe ne  
për ty Minia: trëndafil ! . . . —

Tallen shoqet përsëri,  
po Mineja mban mëri,  
se çdo vashë Canen do,  
ndaj nuk rri e s'flet me to!

\* \* \*

Doli fjala, mori dhenë:  
«Cania dashka fort Minenë  
dhe Mineja Canen do,  
pupu, ç'punë qënka kjo!»

Ja . . . kështu po flet graria,  
pëshpërit dhe nusëria,  
mërmërit dhe vashëria,  
porse Cania me Minenë  
sa her' delnin me kopenë,  
syn' e zemrën kishin fjalë . . .  
Ja, një ditë, me ngadalë,  
në të ngrysur, në korë,  
fjal' e tyre zuri fije  
për tetashin e një dhie,  
u ngre laku i dashurisë,  
larg nga syt'e njerëzisë:

— Minë trëndelinë,  
ma ke parë dhinë?  
— Cilën? Dhinë shytë?  
Nuk ma zunë sytë!

— M'iku nga kopeja.  
u trëmb nga rrufeja,  
m'iku egërsira,  
ah, e marrt' e mira!

— Shih në tuf' një herë,  
ndoshta ësht' përzjerë,  
po s'më the, o Cane,  
është me nishane?

— Po, moj hije-rëndë,  
ngjan me syrin tënd:  
Kur e shoh që lark,  
drejtë më vështron;  
kur i sillem qark,  
bebzën rrötullon!

— Je çoban i ri,  
s'marrke erë ti,  
dhit' ashtu vështrojnë,  
kur barinjt' pergjojnë!

— Qënk'e regjur ti,  
unë s'para di  
ja dhe një çudi:  
Kur i qasem pranë,  
ikën shpejt matanë;  
kur kërkoj ta zë,  
nis vërrét... s'më lë!

— Or çoban i ri,  
dhit' ashtu e kanë,  
mos t'i kapësh ti,  
vinë vetë pranë:  
duan vëndet shkretë  
mbi shkëmbinj e shkurre,  
kacaviren vetë  
nëpër dega, mure,  
shkojnë dhe në gufa,  
kthehen nëpër tufa!

— Po, moj sy-sorkadhe,  
ditke pun'e madhe,  
paske gjak çobani,  
po do shkoj te stani;

prita, shumë prita,  
është errur dita,  
hëna mal mbi mal  
një hosten ka dalë.

— Mos nxito, çoban,  
bëje mir' zanan',  
dhëntë ecin natën,  
kur ka hën' e yje;  
nuk durojnë vapën,  
qofshin dhe në pyje!

— Si t'ja bëj, s'më thua,  
eja, moj, me mua!  
Ndryshe nuk i delet,  
lëri vetëm delet,  
të kërkojmë dhinë  
tutje në rrëpinë . . .

— Ah, o drë i malit!

— Ç'ke nepërk' e zallit?

— Qënke rob i djallit!

— Jo, për syt' e ballit,  
thash' të më ndihmosh,  
të kërkojmë dhinë,  
ndoshta ësht' përposh,  
tutje në greminë ! . . .

Mbetën vetëm lopët, dhëntë,  
rreth e rrotull vinë qëntë  
dhe roshani ka një hall:  
kjo çobanka ç'u bë vall'?

Marrin udhën tatëpjetë,  
kurse Balua rri i qetë,  
e njeh vendin, e di stanin,  
po ç'të bëjë, pret çobanin . . .

Po përhapet bagëtia  
në rudin', nga humbi dhia,  
ndjekin gjurmat, tutje stanit,  
të çobankës, të çobanit!

Pret dhe hëna drit'-venitur  
disa yje që të ndrijnë,  
mbet' kaceri duke pritur,  
gjithë delet blegërijnë.

Ja një drethkë ish vërtitur,  
ajo liosit i qe ngjitur:  
Qesh çobanka me çobanë,  
lis e drethkë vetë janë . . .  
Blegërin përçori, fshihet,  
prapà reve hëna ndrin,  
lehu Balua se pa hijet,  
që lëvrinin në rrëpinë . . .

— O nepërk' e zallit!  
— C'ke, o drë i malit?  
— Shkojmë për në stan,  
po na pret bagtia . . .

— Dale, or çoban,  
ja, vërriti dhia! . . .

\* \* \*

Xha Telhai, burr'i shkuar,  
birn' e vet e kish qortuar

të heq' dorë nga Minèja,  
se do niste gurgulèja  
me Tafilin, si më parë,  
kur një herë për sinor  
ishin ngrënë, qenë sharë  
e q'ahere s'dhanë dorë,  
kurrë më s'u patën parë  
as për gas e as për zì,  
vjete-vjete në mëri ! . . .

Po Tafili qe xhindosur,  
Mînes flokët ja kish shkulur  
dhe sa herë, i kanosur,  
sytë Canes ja kish ngulur!  
Edhe vashat, nusëria  
patën bërë qimen tra,  
edhe plakat, nga lakkia,  
kishin bërë mizën kà ! . . .

## II

U hap fjala stan për stan:  
Gjith' barinjtë fjalën dhanë  
të qënosin bagëtinë,  
se mjaft muarën lemerinë  
për kullot' e për vëri,  
Ishin sharë edhe vrarë,  
po dhe malli i kish marrë  
për një natë në shtëpi,  
për një javë me fëmi,  
dhe me nusen pranë e pranë,  
se me vjete stan për stan,  
si në dimër dhe në verë,  
iu qe bërë shpirti sterrë  
sa që kockat atje lanë!

U hap fjala si veriu,

Po Tafili dhe Sitkiu  
buzën shpejt e shtrëmbëruan,  
kur pér gjén' e gjall' dëgjuan  
të qënosesh gjithë tok,  
se me njerëz varfanjakë  
do të ndanin kok' pér kokë  
qar të paktë me ortakë!

«Këmb' e kokë s'mblidhen tok!»  
Kishte thënë xha Tafili,  
q'atë ditë kur dëgjoi  
dhe barinjtë i mallkoi . . .

Po Sitkiu qe në hall,  
atij mëndja iu bë dhallë,  
Bardhua shumë kish ndryshuar,  
e kish ndruar ushtëria,  
tok me shokët qe gëzuar  
të qënosej bagëtia ! . . .

Fshat' i téré prej gëzimit  
kish vendosur ndaj të gdhirë,  
mu në vath' të Cane trimit,  
të kremonin sa më mirë  
këtë ditë të shënuar  
pér stanarët e uruar:

Cucat veshur e stolisur  
po kércejn' e po këndojsnë,  
herë ulin syt' e shkruar,  
herë trimat po vështrojnë.

Ja dhe trimat veshur-ngjeshur,  
ja, stanarët sy — bakër,  
njeri-tjetrit syn' ja shkelin,  
pér mikeshat zemra: cér ! . . .

Ja dhe pleqtë nëpër hije  
ndjenë veten pak si ngushtë  
se të rit' e tyre iku  
si shkon vapa tok me gusht!

«Pa dëgjoni, pa dëgjoni,  
e ka fjalën xha Kamanı,  
çobanbash' i fshatit tonë:  
— Ju kam sjellë që nga stani  
dy dhurata për kremitimin:  
një ogic, një shark, të dhirë  
për çobankën, për çobanin,  
që do hedhë vallen mirë! —»

— Lum Banushja, lum Banushja! —

Thirrën shoqet me zili.

— Lumthi Cania, lumthi Cania! —

Thirrën trimat për karshi.

Sa me naze vjen Banushja  
si një flutur nëpër lule,  
ndrit jeleku që së largu  
edhe linja me baxhùle,  
zu' të skuqeji, uli sytë,  
se zambaku shtriu fletën,  
e këputi nazemadhja,  
dhe stolisi shpejt gërshetën.

— Hajt, Banushe, hiqe valle<sup>ni</sup>,  
buçet kënga anembanë,  
cila do kërcej, më mirë:  
veç ogicët, një gjerdhan,

Gjerdhan-gushe me merxhane,  
që ka blerë fshati vetë,  
nxir shaminë, o moj xhane,  
se ty vallja po tē pret! —  
«Hiqe vallen shtruuar-o,  
moj fustan-shkurtuar-o . . .»

Ja Banushja si perrìa,  
kur tē çfaqet rrallë n'ëndër,  
dridhte belin e këputur  
përmbi gishta, përmbi thëmbër;  
pa po kindat rrotull linjës  
fërfëritnin si një fletë,  
që vërtitet nga veriu  
dhe pastaj pushon e qetë! . . .

«Hiqe ndryshe vallen-o,  
mos ma ul qepallen-o!»

Pa ja nisi valles dyshe,  
vet' e mori, vet' e hoqi,  
u mahnitën si gjahtari  
kur nga pas thëllëzën ndoqi;  
pa po ulej edhe ngrihej  
si një degë trëndafili,  
që nga kënga nis e dridhet,  
kur mbi tē ja thot' bilbili!

«Mjaft e hoqe vallen ti,  
moj, tē prefshin syn' e zi! . . .»

Faqe bardhë-qumështorja  
po na skuqej posí shega  
edhe fshihej si planosi  
nëpër fleta, nëpër dega . . .

Tutje hiqte vallen Bardha,  
këtej Balja, pranë Bulja:  
gjith' guguçet porsi dardha,  
kur mbi të harliset lulja,  
ndalën vallen, ulën sytë,  
si Banushja s'kish të dytë,  
prandaj gjithë po këndonin:

«Lum Banushe, merr gjerdhanë,  
hoqe vallen më të bukur,  
merr ogicin laraman!»

Po Banushja uli sytë  
dhe u skuq posi kaftan!

Përtej pleqtë si vandak  
nëpër hijet psherëtijnë,  
trimat, vashat pëshpërijnë  
skuqur faqet bërë flakë . . .  
se lëvrijnë si kallinjtë,  
kur veriu fërfërin,  
se qëndrojnë posi vida,  
kur në çerdhe krahët shtrin . . .

— Hajde, Cane, radha jote,  
më të lumtë, tungjatjeta! —

Dridhej teli i jongarit,  
po gjëmonte dhe gërneta,  
doli Cania tok me shokët,  
veshur-ngjeshur bukurë,  
pas daulles hodhi hapin,  
tundi, drodhi një shamë:

Fustanela kinda-kinda  
pas gërnetës i qe nderë,

hidhej, dridhej si billionja,  
kur veriu frushullin;  
këmb' e bel mbi kok' të shokve  
rrotullohej nëpër erë,  
ulej lehtë përmbi barin  
dhe qëndronte si shqiponja.

«Lum Mineja, mjer' Mineja,  
që s'po ndodhet këtu sot,  
të vështronte Cane-trimin,  
që kudo s'ja shkon njeri ! . .»

Ja kështu me vete flitnin  
Vashat-syska, nûre-plot,  
dhe vështrimin ja vërvitnin  
Cane trimit, në fshehtsi!

— Më të lumtë, Cane-trimi,  
hodhe këmbën si kaprolle,  
merre sharkën, është jotja,  
me shëndet dhe ma gëzofshë! —

Çobanbashi e-uron  
edhe fortë brohorit:  
«Rroft' e goft' brigata jonë!»  
gjithë fshati duartrokit . . .

«Pa dëgjoni, pa dëgjoni,  
kini mëndjen ju stanarë,  
nesër niset tuf' e parë  
bigës malit në vërrì,  
unë vetë do ta prij!  
Kush të mbesë, do të marrë  
krerë tjerë amanet,  
tuf' e dytë sa më parë  
të na vijë me shëndet!»

Çobanbashi me të sosur,  
këng' e gaze nakatosur  
vlonin fshatit anembanë,  
veçse Cania mbet në stan,  
se mos vinte, në të ngrysur,  
kjo Mineja sypërmby-sur!...

Pa po priti... u bë natë  
dhe në shtrungë shagun shtroi,  
vet' u shtri edhe me brrucin  
shpejt ogicin e mbuloi,  
prapa shpinës dashi-sharmë  
po e mbronte të mos ftohej,  
nisi Cania të dremite  
e me èndrrën të gëzohej:

«Pa veten sikur hyri në një pallat të math,  
n'oborrin po mërzente kopeja, te një vath,  
rrethuar me shtëparë, pa krrabë, po me ûshta,  
me élme nëpër krye, me hekura në grushta,  
të gjithë rojet trima, i kishte vën' Tafili,  
që dhëntë dhe Minenë, t'i ruanin nga bandilli!...

Një shtojzovalle doli, ashtu siç ja kish ènda,  
i dha dyzetë çelsa të shihte dhomat brënda:

Cdo dhomë çeli Cania dhe mbeti i habitur  
nga tylet e hyrive, që duart kishin shtritur  
për ta spërkatur Canen me ujë trëndafili...  
Me myshk e tymë ùdi këndonin si bilbili  
të gjitha shtojzovallet dhe qeshnin, kuvendonin,  
pëllumbat përmbi flokët me krahët i takonin!...

Hyrive, kur kërcenin, për 'të u digjej xhani,

u mbushën gjithë dhomat me erë jargavani,  
u shtritën pranë Canes, po flladi i pranverës  
zu t'i largoj' ngadale, i mblodhi afër derës:  
flok-gjata që të gjitha, bel-holla, sy-mëshqerre,  
po shtynin njera-tjetrën, pastaj një krismë dere,  
i prapsi qaf-sorkadhet, u çdukën shtojzavallet,  
nga syt' e tij u fshehën, pushuan këngët, vallet . . .

Mineja nûr e dritë me lule dhe kurora  
nga dhom' e fundit doli dhe Canen zu' nga dora!...»

Po kup' e qiellit zbardhi  
dhe Canes, që po flinte,  
i erdhi pran' ogiqi  
në dorë e lëpinte . . .

U zgjua ky çobani, se tepër ëndërriti,  
në lum u nis me tufën dhe thellë psherëtit!

### III

— O Bardhosh, o djalë, pa më pyetur mua,  
ma coptove zemrën, më le duar thatë,  
dhiakonarët tanë zot u bën në fshat!  
E ç't'u desh, ty djalë, tufën të ma ndash,  
me shëllir' e hirë nën' e bab' të mbash ? ! . . .

— Mos nxito, or babë, merre pak më shtruar,  
kështu the ahere, gardhet kur i hoqëm,  
kur bashkuam arat, tok për t'i lëruar;  
të kujtohet dita, kur të dy u poqëm,  
kur ushtar u vesha edhe kur më vonë  
fjalë kaq të mira shkruaje gjithmonë ! . . .

— Po, mor bir, se tokë është në vënd, aty,  
edhe bereqeti matet shpejt me sy,  
kurse gjë e gjallë ujkun e ka pranë,  
ujkun me dy këmbë, brënda mu në stan;  
gjalp' i par' i rrashur, thel' e djathit njomë  
me drâ dhe shëllirë buzët do na njomë!  
Zoti e bëftë mirë dhe për hajër daltë,  
helm' i zemrës sime u ndërrroftë në mjaltë!...  
Bir, tani është koha, nënën dhe babanë  
t'i gëzosh së shpejti, se pak ymër kanë;  
tani q'ushtarllëkun kreve me shëndet,  
të kam zgjedhur nusen, si do Zoti vetë:  
Goxha çupë është, Zoti na e faltë,  
bijën e Tafilit, emr' i Zotit daltë...

— Ç'po më thua, babë, qënke bër' tuaf,  
ç'dashke të më japësh lulen e këputur,  
të më bësh dhe hasëm, qoftë për një llaf  
me vëllamin, Canen, që më pati futur  
të kandis Tafilin, se kështu shkon mbarë  
Minen vetëm Cania duhet që ta marrë!

— Ç'thua, je në vete? janë fjalë bote,  
shoqe s'ka Mineja, është nusja jote!

— Or, baba, ç'më thua, s'ditke gjë as ti,  
vjetë ka Mineja që me Canen rri,  
ç'dashke ti për djalin lule pa saksi,  
të këtillë nuse më ke zënë ti?...

— Ej, po flet përcartë, mos e humb toruan?  
Minia, me t'u rritur, u mbyll në shtëpi,  
ajo ka tri vjetë që s'ka parë kruan,  
pa lë ç'hotë bota, pa lë ç'thua ti!..

— Pa dëgjo, dëgjoje si gjëmon xhuraja,  
shih në kodër Canen, për atë këndon,  
është këng' e krojitet, e di gjith' dynjaja,  
kështu me Minenë ai kuvëndon . . .

Ja ka ngjitur Mînes, kur për her' të fundit  
panë njeri-tjetrin krojitet të katundit!

Shihe dhe Minenë, ja ku ësht' aty,  
në dritare dolli, loti pik' në sy ! . . .

E dëgjon, o babë, këngën, e dëgjon?

Është zëmr' e Canes, vjete që rënkon:

«Doja t'ishja vetëm krua,  
uj' i freskët, i kulluar,  
e të derdhesha si prrua  
që t'i laja syt' e shkruar!

Nëpër plisa, në ugare,  
në gjethishtet, sipër barit,  
ku rri Minia me manare,  
t' ishja fresku i beharit . . . ,

Oh, mbi lulen të pshertija  
që këputi dor' e saj,  
se pastaj në gji do rrija,  
do të thaheshha kollaj!

T'ishja krua, s'doja tjatër,  
uj'i freskët, i kulluar,  
të vaditja, aty afër,  
atë mollën e shartuar.

Pa do vij' ajo bel-hollë  
sipër degës të qëndrojë,  
të këpusë kokrra mollë  
edhe ujë të kërkojë.

Pa do cikja buz'-thelpinj,  
nëpér dhëmb' do gurgulloja,  
do pikoja në gishtinj  
e si ruaza do ndriçoja...

T'ishja vetëm krua doja,  
uj' i freskët, i kulluar,  
brënda shtëmbës të qëndroja,  
të më mbanin ato duar...

Oh, sa bukur, tok me shtëmbën  
do të rrija përmbi kokë  
të Minesë, që hedh këmbën  
si sorkadheja mbi tokë!...

Si të derdhesha mbi duar,  
te zambaku në saksinë,  
nëpér gji, i avulluar,  
do të gjeja dashurinë...

Moj Mine, të ishja krua,  
moj e hequra si bari,  
pranë vetes un' të dua  
të laj lotët posa ari...

Doja t'ishja vetëm krua,  
se kështu do jesh me mua!»

— Deh, ç'më shohin sytë, paske hak, o bir,  
po Tafil syleshi nuk i paska parë,  
si s'e mbyllka plagën, por e lë të çarë?!

— Ku ta shoh Tafili, niset pa gëdhirë  
të kullosë berrat tutje buzë prrojitet,  
vetëm atëherë ndihet këng' e krojitet!

— Obobo, dynjaja fare qënka çthurur,  
s'është pér tē sharë, as dhe pér t'u mburur,  
Kam fëmi un' vetë, far' e fis, gjitonë,  
mund tē bjer' belaja dhe në kokën tonë!  
Qënka me telâshe miku im i gjorë,  
mikut tē shtëpisë duhet t'i jap dorë,  
do t'ja mbush dhe mëndjen, plaga do melhemin,  
miku pér xhenetin, hasmi pér xhenemin! —

Uli syt' Sitkiu, Bardhua qeshi pak,  
vashat ligjëruan tek lëronin n'arë,  
sytë si shigjeta, vetullën si hark,  
ja vërvitën Canes që s'e kishin parë!

#### IV

Kur Mineja me kopé  
kishte dalë në lëndinë,  
se i jati s'pati nge,  
Cania bashkë me bagtinë  
u shkëput që lart nga stani  
si vërvitet vrik rrufé  
një trumcak nga jargavani,  
kur sheh flutrën në folé! . . .

Një cop' her', pa i përgjuar,  
një shtërgat' i pat bashkuar:

— Lumi vjen si trubull, buz' e malit nxin,  
o Miné, mblidh dhëntë, e ke larg shtëpinë!

— S'marrke vesh, o Cane, s'e njeh kohën tì,  
paske shumë frikë, nuk do bjerë shi!

- Qënke mëndje-shkurtër, moj gërshetë-gjatë,  
sënpjet ke për ta parë shiun me shtërgatë!
- Ku. .ku. .ku sa qesha, qënke shum' i zot!
- Vëmë bast, po deshe, pse flet kot së koti?
- Mirë, hajt e vëmë: në fitofsha unë  
do më japësh shqerrën, atë lara-lara,  
në fitofshë, Cane, do më mbash në gunë,  
se ta fal dhe Syskën, që po rri përpara.
- S'ditke hiç kërcüre, s'vihet bast mbi gjënë,  
as mbi mall e tokë të brigatës sonë.  
po dhe gunën dashke, të më lësh në shi  
e pastaj të tallesh, o moj tiftirë!
- E po ç' dashke, Cane, xhevair nga deti,  
nuk ta zënka syri mallin e tim eti?
- Jo, këçulja ime, dua një stoli  
që të jetë jotja dhe të ndahet dysh,  
si atë që fshehe brënda mu në gji,  
se të zuri frika, mos ta merrja sysh!
- Ej, çapkën, mbyll gojën, mos e bëj të gjatë,  
se lëshoj dhe Mûrron, mishin të ta xhvate!
- Pse je kaq e keqe,  
flas me lepe-peqe  
të kërkoj qëndimën, të kërkoj një dardhë,  
që ma ke qëndisur në pëlhir të bardhë.

— Mirë, deh, po ti,  
në mos rëntë shi?

— Po ta fal zambaren, që porsa e sosa,  
dhe një rrashë të zhgabës, që mezi plagosa,  
në mos të pëlqefshin, po të jap pér jetë:  
një gjerdhan merxhanesh si të Bukrés-dheut,  
del si del ky basti, si do që të jetë,  
pa ta fal, po deshe, gunën e shëndreut!

— Dale pak, o Cane, ç' pati kjo kopeja,  
m'iku dhe pérçaku, u trëmb nga rrufeja! . . —

U nxi qielli, u bë sterrë,  
vetëtin mbi mal matanë,  
ves' e shiut po cikrron,  
puth së pari jargavanë,  
nis nga pak të dëndësohet,  
trëkëllin e hyn në rrëza,  
njomi dorën e një vashe,  
kur e shtriu te thellëza! . .

Ja, po çthur e çkul kjo era,  
po breron e shkrepëtin.  
Dëndësohen ret' e zeza,  
gjithë qjelli uturin! . .  
Ja dhe lulet ulin fletzat  
edhe gjirin po mbulojnë,  
s'i shkul dot as suferina,  
njera-tjetërën pérqafojnë!

Ja stuhia zilijare,  
hodhi pika më të trasha  
që dhe degët të kullonin,

se strehonin disa vasha,  
disa vasha ler' e rritur  
në dericka, nëpér puse,  
që po thurnin dy kurora  
pér një dhëndër, pér një nuse.

Po duhia hodhi breshër  
u vërtiti suferinën,  
t'i bëj' qullë bukuroshet,  
që po pritnin në lëndinën!  
Njëra vashë ngashëroi  
dhe furtunës po i lute;,  
se iu dhimbs zambaku pranë  
që nga rrënja po këpuntej!... .

— A ke ftohtë, or kajgush,  
se kjo guna s'po na nxë?

— Jo, se ty të kam pér prush,  
mos ki frikë, s'më gjen gjë!

Fshiku prapë rrez' e djellit  
nëpér plepa të coptuar,  
ndriti lartë kup' e qiellit,  
u duk djelli si brerore  
dhe nga gjit' e trëndafilit  
doli flutra krahëshkruar,  
ja, së largu ylyberi  
po hepohej mbi bregore!... .

— Ej, Miné, iku shtërgata,  
shkojmë pa na zënë nata!

# V

Zjarr' i stanit mala-mala,  
 flaka brambullin te prushi,  
 në ęeturin pala-pala  
 gjiz' e njom' në fleta bushi  
 dhe stanařet rr̄eth e qark,  
 hedhur shpinës nga një sharkë,  
 thekin bukën, kuvendojnë,  
 njeri-tjetrin po ngacmojnë... .

Nëpér vath' e shtrungje dhëntë  
 kok' pér kokë po dremitin,  
 nëpér gardhe lidhur qëntë  
 her' pas here hamulitin!...  
 Vetëm Çapi s'është lidhur,  
 rri te zjarri duke-u dridhur,  
 është plakur, s'ka fuqi,  
 çobanbashit pran' i rri!... .

Ja dhe Cania prehrit mban  
 bello-bardhon, flok i borës,  
 nga matarja, që ka pranë,  
 uj' i jep në grop' të dorës,  
 e fërkon dhe e lëmon,  
 me mullagë ja mbulon  
 plagën q'është anjur pak,  
 çar' nga cjapi torollak!... .

«Pa dëgjoni, o stanařë,  
 malli shumë më ka marrë,  
 pér shtëpi dhe pér fëmi!  
 Vëndin tim ka pér ta zënë,  
 ndonse është më i ri,

Cania q'është më i dhënë.  
Ta dëgjoni si të parë,  
ta mësoni, ësht' i ri;  
pushk' e tij nuk ka të sharë,  
mbi çakenj e ujq ai  
të qëlloj' më mirë di!...

Pa dëgjoni, bijt' e mi,  
vjédrat, butet dhe kadishtet  
matarât e çdo kusì  
t'i férkonî me barishtet,  
të m'i lani të m'i shplani!  
Edhe ju, o djem delméré,  
kini mëndjen si pérherë,  
se bulmeti, që tanî,  
s' mbaret më me matarâ,  
as me nàpa, me kusì,  
po me kâde, me fuçi,  
zbret me duar e me krah  
nëpër qerre, araba!...

Kini mëndjen, ju shterparë,  
delet duhet t'i ndërzeni,  
kjo të jetë pun' e parë!  
Mos harroni që të veni  
tok me delet e sémura  
n' atë fermën, ku ju shpura  
pér heqimin, hern' e parë,  
mos harroni, o shterparë!

Kini mëndjen, o stanarë,  
ndani mirë dhe hiséné  
edhe qarin hak pér hak;  
mbani radhën e vadénë  
pér secilin shok ortak!...

Për ty, Cane, amanet  
sikur t' isha unë vetë!»

Çobanbashi këto tha,  
hoq pagurin dhe silahun,  
afër zjarrit ai ra,  
bëri lutje për allahun;  
gunën sipër shpejt e hodhi,  
duar, gjunjë tok i mblodhi  
që ta zinte gjumi mirë,  
se do zgjohej pa gëdhirë...

\* \* \*

Cania desh t'i thosh dy fjalë  
çabanbashit q'e lëvdoi,  
po me bryl një shok ngadalë  
nuk e la të kuvendojë.

U skuq Cania posa flaka,  
kur të gjith' e përgëzuan,  
nga një herë si me shaka  
për Minenë e ngacmuan...  
Nat' e shkurtër, dit' e gjatë,  
porse ftoht' atje në shpat,  
flak' e lisit mala-mala,  
nga të qeshurat, shakatë  
nëpër buzë mekej fjala,  
se kur flet Zyko stopani,  
shkulet gazit gjithë stani...  
Po tregonte për një kec,  
që në vresht të hoxhës fshatit  
kishte hyr' e kishte ngecë  
kur i ra me bisht të shatit,  
se ky hoxha-e kish zakon

në vresht tij, çfardo të shkelte,  
për atë do bëhej pronë  
dhe nga gardhi më nuk delte!

Zykua hakun e kish marrë  
kur i futi një derrucë,  
bridhte hoxha si i marrë  
nëpër vreshtin, pa këpucë,  
dridhej mjekra, dollomaja  
me një derr e zu' belaja!  
Desh ta vras' për pastërma,  
po kish frik' e për belà  
hapej fjala anembanë:  
«Hoxh' pa din' e pa imanë!»  
Derri vreshtin ja shkallmoi,  
po nga gardhi ç'i shpëtoi,  
se të gjallë desh ta kapë,  
tram ta bënte me një cjap! . . .  
Cania kishte qeshur shumë,  
po kur kishte rën' për gjumë,  
si për nat' e këtë herë,  
për Minenë bëhej vrer. . .

E kujton me krrab' e furkë  
si gëzohej me sheleg,  
tani mbyllur, loti çurk! . . .  
E kujton kur përbëti degë  
dorën shpejt e kishte vënë  
që të ndreqte çerdhen vetë,  
se mbi gjeth e bar kish rënë! . . .  
I kujtohen dit' e netë,  
po më shumë ajo, dhia,  
rrëz' e kodrës dhe stuhia! . . .  
Këng' e krojit e lëndon

dhe pshertin që s'po i bije,  
s'e lë Zykua e ngacmon,  
e quesndis e thumb i shtje!

\* \* \*

«Hën' e re, moj hën' e re,  
Cane-shpirtin a ma pe?  
o ju yje, o ju yje,  
Cane-xhani ësht' në pyje?  
O ju pyje, plot me bushë,  
o ju zoq, o ju kajgushë,  
ju q'akoma nuk po flini,  
Canen, Canen a e dini?...»

...Ja kështu përçart Mineja  
flet me yjet dhe me hënën  
edhe loti si rrëkeja!....  
As me shoqet, as me nënën,  
ç'i thot zemra, nuk po flet,  
se ky Cania ka një vjet  
që në fshat na vete vjen  
dhe s'po ndihet për Minenë,  
as me fjalë, as me zë,  
as me culen si gjithnjë!...

Nat' e errët, sterr' gjithkund,  
prehen, flerë në katund,  
asgjë rotull s'pipëtin,  
veç një degë kërkëllin,  
toroleci férshëllin,  
dhe një ferrë frushullon:  
ndoshta gjoni po vajton  
deg' më deg' vëllan kërkon,

ndoshta kthehet si pak von  
ndonjë harabel-çapkën,  
ndoshta gjarpri do ket' zënë  
ndonjë flutur krah-këputur...

Nat' e errët, sterr' gjithkund,  
prehen, flenë në katund,  
veç Mineja s'paska rënë,  
lemza dëndur e kish zënë  
atë natë, kur kish parë,  
majë shpatit goxha zjarr;  
pa mendonte dhe kujtonte  
rrotull flakës plot stanarë  
tok me Canen çehre-vrarë...

Sa her' shpatit zjarri ndizej,  
te Mineja èndrra ngjizej,  
po kjo flaka larg në stan,  
që lë prush e hirin nd'anë,  
nuk e ngroh, as e ndriçon,  
ësht' si yll që xixëllon...

Po Tafili?... Ka një hall,  
ka një leqe mu në ballë,  
ndaj në shtrat po përpëlitet,  
se kudo në fshat po flitet  
si ta heq' e si ta lajë,  
s' ësht' e lehtë, as kollaj,  
atë leqe për Minenë!...  
Kish dhe dertin për kopenë,  
që kish marrë lemerinë,  
nat' e ditë blegërin,  
se dikur në gjelbërimë  
hangri majn' e barit njomë,

ujë piu në burime,  
tani gjethe nëpër llomë,  
se Minenë s'e ka pranë,  
ka Tafilin për çoban! . .

E po nëna e Minesë?  
Nën' e zezë, nën' e gjorë,  
mbetur fill e pa një shpresë,  
se nuk kish asgjë në dorë,  
ndez qerì edhe tylbesë  
nat' e ditë po i falet,  
t'i heq dertet edhe hallet! . .

E po Cania ç'bën në stan,  
qëkur Minen s'e ka pranë?  
Cania shtritur po kujton,  
po kujton, po ëndërron  
edhe flakën po vështron. . .

Dhe Mineja në dritare  
pret të shuhet flaka fare. . .

Flak' e lisit u venit,  
hijen prushit s'ja hedh më  
ja dhe prushi u tonit,  
sipër vetes hirin lë  
posi syçkat e Minesë  
dhe të Canes, larg në stan,  
q'u venitën gjer mëngjes  
edhe drit' në zemër lanë. .

## VI

Buzë prrojitet, në plepishte,

te kulloste bagëtia,  
xha Tafili éshtë shtritur  
dhe rri mvrejtur nga mërzia! . . .  
Po vështron një fije bari  
q'ë këputi n' atë ças  
dhe me veten si qyqari  
po ngulçonte plot maras:  
«Ej, Tafil, Tafil i shkretë,  
si një fije bari je  
që s'ka rrënëjë, që s'ka fletë,  
shkelet, thahet përmbi dhë!  
Si s'të dha ky Zot një djalë,  
po të la kaq rrënëjë-dalë,  
me një feçkë për belâ,  
për belâ dhe për hatâ!

Posi lis në mal u thafsha,  
si bujashka un' u çafsha:  
mbi zagarin plumb' i parë  
dhe mbi bushtrën plumb' i dytë,  
ndryshe njolla s'ka të larë,  
turpin lak do kem në fyt! . . .»

. . . Mërmëritjen shpejt e preu,  
se ca hapa sikur ndjeu:  
Ish Kamani q'ë përshndeti,  
çobanbashi erdh' e gjeti,  
kish dy fjalë për t'i thënë,  
lajm të mirë për t'i dhënë:

— Tungjatjeta, o Tafil!

— Mirsevjen, oré Kaman!

đhin' e ndarë nga kopeja  
e ha ujku-e vret rrufeja!...

— M'është mbushur mëndja top:  
me të tjerë s'e bëj dot!  
Të më mbushësh mëndjen mua  
paske ardhur, o Kaman,  
ti e di që unë s'dua,  
apo fshehur diçka mban?

— Të kam folur si një shok,  
nuk të fsheh asgjë në kokë,  
mendo mirë dhe një herë,  
veç të mira ke dhe nder!  
Do të them diçka tani,  
për një gas, na qoft' hajli:  
Të kam ardhur për lajmsi,  
me Telhan' të bësh krushqì,  
Cania është deli djalë  
dhe Mineja, vajz' e rrallë!

— Si! Ç'më thua, or Kaman,  
të jem krushk un' me Telhan'?  
Sa më hoqe thikn' e parë,  
tjetrën ti ma ngule thellë,  
s'është punë, as ka ngjarë,  
veçse èndrra mund ta pjellë:  
Të laj gjakun me raki,  
të marr hakun me dollì,  
nderi turpin për krushqì?!

— Ti as hak' s'ke për të marrë,  
ti as gjak' s'ke për të larë,  
s'jeni prerë, s'jeni vrarë!...

— Gjithë fshati ka marr' erë,  
më ka prekur mu në nder,  
i preu fatin sime bijë,  
as një lajmës gjer tani!  
Më la leqe në shtëpi  
dhe tani kërkon ta lajë,  
dashka vajzën, qerataj!

— Eh, Tafil, të rënt' damllaja,  
çërikë prapa nga dynjaja,  
kruake kokën kur s'të ha,  
ti bën «ish» kur pula s'ka,  
gjersa vajzën ta kërkon,  
ç'farë haku ti sajon?

— Vajzën un' e rjep të gjallë  
edhe Canes nuk ja jap!  
Të kam mik, orë Kaman,  
porse fjalën merre prapë,  
se më there mu në xhan! . . .

Këto tha edhe u ndes,  
pa u skuq, u bë si spec,  
dhe kopenë vu' përpara;  
i xhindosur me të shara,  
ja la fjalën mu në gojë,  
iku poshtë nga përroj. . .

## VII

U fik zjarri majë shpatit, me të mbritur vjesht' e  
dytë,  
po në zemrën e Minesë kishte shkrepur një shkëndi  
që ta ngroh' e ta ndriçojë, se iu errën të dy sytë,  
qëkur Cania me stanarët kishte ikur në vërr! . . .

Vjesht' e dytë në të dalë hodhi fletët nëpër dhé,  
zverdhi, thau dushq' e lisa, trëndelina zu të

ros' e egër kuàku qjellit, po vërtitej pér folé,  
mardhet,  
bubu, ç'dimér do të vijë, edhe fusha do të zbardhet!

Vjesht' e tretë në të dalë çveshi, shkundi gjith'  
stolitë,  
po pranvera, që kaloi, e la nurin te Mineja,  
se stanarët rrëzë malit po kullotnin bagëtitë  
edhe Cania, ndonjë herë, do shkëputej nga kopeja.

Shtatë shtalla dhe katoje rrëzë malit mbi lëndinë,  
shtatë mëndra, shtat' silazhe, shtat' livadhe me mu  
llarë,  
shtatë javë ka Mineja, që po qan e psherëtin,  
se Tafili e ka mbyllur, s'i jep leje as në arë! . . .

Edhe djelli edhe hëna që shkëlqejn' nga bukuria,  
kanë njollat, kanë hijet, kanë retë vark e vark,  
ndaj te zemra e Minesë shkundi hirin dhe shkëndia,  
se Tafili si thëllimi nuk e la të ndizej flakë . . .

Po ashtu si manushaqja që mban breshër dhe stuhì,  
po ashtu si trëndafili që rrebeshin mban me shì  
dhe s'u shkulën, por u çelën, hapën gjit' pér djell  
e vesë,  
edhe luleshqerr' e kputur ra në zemrën e Minesë.

Atje zunë rrënëjë fletzat, që këputën tok me Canen,  
edhe çdo pranverë çelnin tok me kumbllën, me  
bajamen,  
po pranver' e shtatë Minen s'do ta zinte në shtëpi,  
shtatë netë kish menduar, pran' Tafilit më s'u  
gdhi! . . .

\* \* \*

Nat' e gjatë në shëndre,  
me murrê dhe kërcëllimë,  
kok' pér kokë në kope  
flenë dhëntë në thëllim.  
Nëpér vatra zhuzhurit  
flak' e lisit q'u godit  
nga rrufé e vjeshtës parë;  
ndonjë qën po hamulit,  
se diç pa aty në arë!  
As të vegjlit s'kanë rënë,  
se ja gjyshja dhëmbë-ränenë  
një përrallë u tregon,  
një përrallë që s'mbaron...

Nat' e gjatë në shëndre,  
po stanaret shpejt po flenë,  
vetëm Cania sonte s' fle  
tok me Kuqon ruan kopenë;  
Zuri pritë në leptyrë,  
pushkën ngrehur bënte rojë,  
po një mjegull si lëbyr  
nuk e linte të përgjojë...

Nat' e gjatë në shëndre,  
errësira gisht në sy;  
në koçek Mineja u fsheh  
sa të zbardhë pret aty,  
se te Cania do të shkojë  
se diçka do t'i tregojë...

Në koçek ajo po rrinte,  
nat' e gjatë, s'po gëdhinte,

se në mjegull, n'errësirë,  
kishte frikë të shtegtojë,  
mos i delte nj' egërsirë,  
ishë e vetëm, pa mburojë...  
Priste gjelin më të parë,  
gati rrugën për të marrë!...

Nat' e gjatë në shëndre,  
po kjo sonte qe m'e gjatë,  
as një gjel në fshat s'u ndje,  
sikur s'kish mbarim kjo natë,  
për Minenë në koçek  
s'kishte hënë, s'kishte shtek!...

Po në vënd të gjelit, krisi:  
pushka pushkën bëri bam,  
ra një pushkë, dy dhe tre,  
një zhumbur që larg në stan,  
po gjëmon një bataré,  
hamulijnë qënt' e stanit,  
sokëllin zër' i çobanit,  
blegërin e gjith' bagtia  
ulurin dhe lukunia,  
me llahtar u ngrit njerzia:  
«Ç'ësht' kjo gjëmë që na gjeti,  
s'janë pushkë në dasmorë,  
s'janë pushkë në taborë,  
s'janë pushkë as për zjarr,  
as për prita, për kusarë,  
janë pushkë në stanarë!

Ngrihet nëna e Minesë  
pa këthehet drejt qabesë,  
nis të lutet dhe të dridhet,

te Mineja shpejt po hidhet,  
se mos trëmbet vajz' e shkretë,  
pushk' e madhe po kërcet! . . .  
Nën' e zezë ngrin në vënd,  
bije dëng e si pa mënd,  
hop në këmb' Tafili plak,  
ndez kandilin në buxhak,  
po zë dridhet si purtekë  
për të bijën, nga inati,  
del në mjegull shtek më shtek,  
llahtaruar pyet fshati:  
«Ç'paska ndodhur në stanarë,  
me Tafilin ç'paska ngjarë ? ! . . .»

«Nëndë dele qënkan çqyer,  
gjak lëndina qënka lyer,  
Cane trimi ka qëlluar,  
po një ujk e kish kafshuar  
në çapok edhe në duar,  
nëndë ujqër ishin vrarë,  
sakatuar dy stanarë  
gjëm' e tillë, s'kishte ngjarë ! . . .»

U hap fjala vetëtimë,  
fshati gjithë pikëllim ! . . .

As Tafilit s'i erdh' mirë,  
veç për Canen kishte thënë:  
«Zoti vet'e ka shpëtuar,  
jetë-gjatë qënka shkruar!»  
Dhe kur Minen kishte parë,  
ngrehu çarkun, por u drodh,  
përmbi pushk' gërmuq u mblodh,  
psherëtiu edhe tha:

«Ej dynja, o moj dynja,  
më tradhtove, lot o lot,  
mbi evlat nuk shtënkam dot!»

Po të shoqes i pat thënë:  
«Gjall' Tafili sa të jetë,  
bushtra ime pajë-lënë  
mos të shkelë në shtëpi,  
e kam bër' harram-lanet,  
ndonjë ujk e past' kësмет !...»

\* \* \*

Dita në të vagëlluar  
me kopet' e qent' përsi  
dhe me qengjin në krahruar,  
zbresin lumi t dy barë;  
ky bariu paska pranë,  
një bareshë si perri:  
lis e drethkë pleksur janë!

Mbajnë pushkën krahës-qafë,  
hedhur supit dhe një gunë.  
fshati s'paska tjetër llaf:  
«Si u bë kështu kjo punë!»  
Vetëm vajzat pëshpërisin,  
vetëm plakat mërmërisin !...

«Moj, si Cania, si Mineja?»  
nisi basti, krisi beja,  
ësht' ajo, moj, si pérherë:  
sy-fajkua, vetull-prerë,  
ja dhe Cania pran' aty,  
ç'po na shohin këta sy !...

Ja Mineja, ja Mineja,  
ja dhe Cania te kopeja,  
si pérhera me xhuranë,  
ja Mineja krrabën mban  
edhe qengjin prap' në gji,  
furk' e bosht s'i ka tani ! . . .

Ja Mineja në stanaré,  
ësht' rrëmbyer, ësht' pérzënë,  
me shelegun lot mbi bar,  
prapë yll e prapë hënë ! . . .  
Me bareshën, me barinë,  
sa me qejf kopetë pinë ! . . .

Hajde-hajde, moj Mine,  
lum ti Cane, lum dhe ne,  
mjaft me brenga dhe me v&.,  
gaze paçit paskëtaj,  
se brigada jon' e stanit:  
Ju ka Yllin e karvanit!

---

## FJALORTH

*breron:* bije shi i madh.

*brerore:* diademë, kurorë e ndritur.

*bigrë:* mal me dy maja.

*Balua:* emër qeni me njolla të bardha, qen bariu.

*baxhule:* një lloj qëndisje në fundin e linjës.

*bushi:* shkurre pérherë e blertë, me drurin e tij bëhen lugë.

*brambullin:* digjet me flakë të madhe duke kërcitur

*bello:* manare, ogiq.

*berra:* bagëti e imtë, pa i cilsuar, desh, dele, dhi, etj.

*cule:* fyell.

*çeturi:* enë e drunjtë në formë të kupës pér të mbajtur bulmet.

*Çapë:* qen stani.

*delmeri:* bari.

*feçkë:* shprehje çvlerësimi dhe përbuzëse pér vajzën.

*gurguleja:* trazirë, ngatërrresë.

*gjam:* zall lumi, ku aty-këtu ka edhe drurë.

*gjeshku:* fletët e thata të drurëve, gjeth i thatë.

*gjerdhishte:* një farë druri me lule të kuqe, që e hanë dhitë.

*gjedhi:* gjë e gjallë, bagëti e trashë.

*Kacéri:* dash me brirë të drejtë.

*kajgush:* bilbil.

*kade:* enë druri që përdoret pér të mbajtur bulmet.

*kadishte:* fuçi e vogël prej druri.

*kaftani:* robë e kuqe.

*Kuqo:* emër qeni.

*koçek:* vënd ku ruhet bereqeti i paçveshur.

*koce:* vajzë e njomë, e kërthinqjtë, ferrishte.

*lemerinë:* panë keq me sy dhe u tmeruan.

*leptyrë:* vënd rrëpitë, ku shkel njeriu dhe kafsha.  
*lëbyr:* perdja që të vesh sytë.

*lukuni:* tufë ujqësh, përdoret vetëm pér ujqët.  
*mëndër:* tufë, kope bagëtish.

*Muro:* emër qeni.

*përçaku:* ose përci: sqap i patredhur që mbahet pér farë.

*përçori:* dashi që i prin kopesë.

*planosi:* zok që mbahet në kafas pér të ndjellur shpesë  
të tjera.

*qinosur* ose *qënosur:* qënos bagëtinë, pra bashkoj të mijat  
me të tjetrit, ortak në bagëti.

*rōshani;* dash me katër brirë.

*rudinë:* shesh i gjërë në mal, i mbuluar me bar.

*silloi:* ra në silloi, në mendim.

*sinori:* kufi toke, are, etj.

*stopan:* bari.

*Syskë:* delja me një rrëth të zi rrotull syrit dhe me njo-  
lla të zeza në turi.

*shagu:* pëlburë e trashë prej liri a kërpi, që shtrohet.

*sharka* ose *sharku:* gunë, brrucë.

*sharmë:* dash sharan, me turi të bardhë, përzier me të  
murmë.

*shelegu:* qengj që ka mbushur vitin.

*shytë:* pa bri.

*shterpar:* bari që ruan delet shterpa.

*udi:* një lloj druri që kur digjet nxjerr erë të këndëshme.

*ushtë:* shtizë, shëgjetë.

*vida:* pëllumb femër.

*zhumhur:* zhurmë e mbytur që dëgjohet së largu.

*vëllam:* shok i ngushtë me të cilin ke pirë gjak dhe je bë-  
rë si vëlla.

*vërrët:* thërrret dhija.

27352  
BIBLIOTEKE SATELLITI  
GJERGJASTEP

TRYEZA E LËNDËS

|                                   | Faqe |
|-----------------------------------|------|
| 1) Bareshës .....                 | 3    |
| 2) Gaze paç ti paskëtaj .....     | 4    |
| 3) Banusheja .....                | 6    |
| 4) Të kam zili .....              | 8    |
| 5) Sikur ti të dije .....         | 9    |
| 6) Pse u fshehe .....             | 11   |
| 7) Sa herë fusha gjelbëron .....  | 12   |
| 8) Xha Temja .....                | 13   |
| 9) Ja, çobanka .....              | 17   |
| 10) E mban mend .....             | 18   |
| 11) Mirësevjen, o kurbetli .....  | 19   |
| 12) Lum, ti lule .....            | 24   |
| 13) U poq rrushi .....            | 25   |
| 14) Falli .....                   | 26   |
| 15) U rrëmbye një vashë .....     | 29   |
| 16) Kajisia .....                 | 32   |
| 17) Dolli reja .....              | 33   |
| 18) Çelu moj, si çelet moti ..... | 35   |
| 19) Mineja .....                  | 37   |
| 20) Fjalorthi .....               | 79   |

Mak.